



Institucioni i Avokatit të Popullit
Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Nr./Br./No. 1334 12019

Nr.i fq/Br.str./Nr.pg.
Data/Datum/Date: 05/08/19

PRIŠTINË/PRIŠTINA/PRISTINA
Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucion i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution



RAPORT ME REKOMANDIME

I

MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS

lidhur me

vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Prizren

Për: Z. Abelard Tahiri, Ministër
Ministria e Drejtësisë

Z. Uran Ismaili, Ministër
Ministria e Shëndetësisë

Z. Nehat Thaqi, Drejtor i Përgjithshëm
Shërbimi Korrektues i Kosovës

Z. Milazim Gjocaj, Drejtor
Departamenti i Shëndetësisë në Burgje

Z. Hamit Ademaj, Drejtor
Qendra e Paraburgimit në Prizren

Z. Ymer Hoxha, Kryetar
Gjykata Themelore në Prizren

Znj. Duda Balje, Kryetare
Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të
Pagjetur dhe Petitione i Kuvendit të Republikës së Kosovës

Prishtinë, 05 gusht 2019

HYRJE

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) i Avokatit të Popullit, më 20 maj 2019, e ka vizituuar Qendrën e Paraburgimit në Prizren (në tekstin e mëtejmë *QPP*).

MKPT-ja, bazuar në nenin 17 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, mund t'i vizitojë, në çdo kohë dhe pa paralajmërim, të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë stacionet policore, qendrat e paraburgimit, burjet, vendet ku mbahen të huajt e privuar nga liria, si dhe institucionet psikiatrike dhe ato kujdesit social.

Sipas njoftimit në ueb-faqen e Shërbimit Korrektues të Kosovës, në *QPP* vendosen të paraburgosurit dhe të dënuarit me dënimë deri në tre muaj. Kapacitetit zyrtar i *QPP*-së është për 92 persona, ndërsa, në kohën e vizitës në *QPP*, ishin të vendosur 84 të burgosur.¹

Qëllimi i vizitës

Qëllimi i kësaj vizite ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave të të burgosurve, të cilat u garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e të burgosurve; si dhe zbatimi i rekomandimeve të MKPT-së të dërguara autoriteteve kompetente përmes Raportit me rekomandime për vizitën në *QPP*, më 31 tetor 2017, i publikuar më 25 janar 2018.²

Përbërja e grupit monitorues

1. Grupi monitorues përbëhet prej një këshilltari të lartë juridik për parandalim të torturës, një këshilltare juridike për parandalim të torturës, një psikologe-këshilltare, një mjeke-këshilltare dhe një punëtore sociale-këshilltare.

Bashkëpunimi i *QPP*-së me MKPT-në gjatë vizitës

2. Gjatë vizitës së MKPT-së në *QPP*, personeli i shërbimit korrektues dhe personeli i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve (DShB) i ofruan ekspert monitorues bashkëpunim të plotë. Ekipi, pa vonesa, pati qasje të papenguar në të gjitha vendet e vizituara dhe iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme për ta kryer detyrën, si dhe iu mundësuan bisedat me personat e dënuar dhe të paraburgosur, pa praninë e zyrtarëve korrektues dhe pa praninë e personelit shëndetësor.

Informimi për të drejtat e të burgosurve

3. Udhëzimi Administrativ MD-Nr. 07/2015 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese (më tej *Rendi Shtëpiak*) përcakton obligimet e institucioneve korrektuese që, menjëherë pas pranimit, të sigurojnë kushte që i burgosuri të njoftohet me shkrim për të drejtat dhe detyrimet e tij/saj. Më tej, *Rendi Shtëpiak* përcakton se *Rendi Shtëpiak* dhe Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (LESP) janë në dispozicion të të burgosurve

¹ <https://shkk.rks-gov.net/institucionet-single/2233>.

² Për më shumë, shih në: <https://www.oik-rks.org/2018/01/31/raport-me-rekomandime-i-mkpt-lidhur-me-viziten-ne-qendren-e-paraburgimit-ne-prizren/>.

gjatë gjithë kohës. I burgosuri, i cili nuk di shkrim dhe lexim, njoftohet gojarisht për të drejtat dhe për obligimet.³ Gjatë vizitës, MKPT-ja vërejti se në dispozicion të të burgosurve janë Rendi Shtëpiak dhe dokumentet e tjera relevante, përmes së cilave të burgosurit njoftohen për të drejtat dhe obligimet e tyre.

Keqtrajtimi fizik

4. MKPT-ja, gjatë vizitës në QPP, intervistoi një numër të konsiderueshëm të të burgosurve dhe nuk mori asnjë ankesë për keqtrajtim fizik apo për përdorim të tepruar të forcës fizike të ushtruar nga zyrtarët korrektues apo për sjellje të autoriteteve të burgut, të cilat do të përbën shkelje të dinjitetit të të burgosurve. Përveç kësaj, MKPT-ja vërejti se ekziston një klimë pozitive e marrëdhënieve dhe komunikim i mirë interaktiv ndërmjet të të dënuarve dhe zyrtarëve korrektues.

Ankesa kundër mënyrës së zbatimit të kontrollit trupor

5. Gjatë vizitës në QPP, MKPT-ja mori ankesa prej disa të burgosurve, të cilët pretenduan se zyrtarët korrektues, gjatë kontrollit, kërkuant prej tyre që të zhvishen tërsisht në prani të të dy zyrtarëve korrektues. Të burgosurit pohuan se kontrollimi trupor është bërë një nga një në dhomën e mbikëqyrësit të krahut dhe, gjatë kontrollit të trupit, prej tyre u kërkua që të ulen, të ngrihen dhe t'i vendosin duart në mur.
6. Duke mos paragjykuar nëse pohimet e tillë janë të vërteta apo jo, MKPT-ja, sikurse në raste të tjera, thekson se të gjitha kontrolllet e tillë duhet të bëhen ekskluzivisht në pajtim me nenin 35, paragrafi 1, të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (LESP), i cili shprehimisht përcakton: “*Personi i dënuar nuk duhet të kontrollohet në mënyrën e cila e cenon dinjitetin e tij. Shkalla e bezdisjes së personit të dënuar gjatë kontrollimit duhet të jetë proporcionale me qëllimin e tij, ashtu siç është paraparë me këtë nen.*”
7. Më tej, nen 35, paragrafi 6, i LESP-së përcakton se kontrolli i trupit të zhveshur të të burgosurit kryhet prej dy punonjësve korrektues të së njëjtës gjini me atë të personit të dënuar dhe në një vend të veçuar, pa praninë e personave të tjerë, asnjëherë nuk bëhet në praninë e personave të gjinisë tjeter nga ajo e personit të dënuar, nuk përfshin zhveshjen në të njëjtën kohë të pjesëve të sipërme dhe të poshtme të trupit të personit të dënuar.⁴
8. Përveç LESP-së, edhe aktet juridike ndërkombëtare për të drejtat e të burgosurve përcaktojnë obligimin e autoriteteve kompetente që, të gjatë kontolleve të tillë, ta respektojnë dinjitetin e të burgosurit.⁵

Kushtet e akomodimit

9. LESP-ja shprehimisht përcakton se i dënuari ka të drejtë për strehim, i cili u përgjigjet kushteve bashkëkohore higjenike dhe rrëthanave vendore klimatike.⁶ Më tej ligji përcakton: “*Lokalet në të cilat jeton dhe punon personi i dënuar duhet të kenë hapësirë të mjafthueshme ashtu që secili person i dënuar të ketë së paku tetë (8) metra katrorë hapësirë për qeli të vetme dhe katër (4) metra katrorë për të dënuarit në qeli të*

³ Udhëzimi Administrativ MD-Nr. 07/2015 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, nen 20.

⁴ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nen 35, paragrafët 6.1, 6.2, 6.3.

⁵ Rregullat Evropiane të Burgjeve, Rregulli 15.4. Rregullat e Mandelës, Rregullat 50, 51, 52.

⁶ Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nen 36, paragrafi 1.

përbashkëta, dhe sasi të mjaftueshme të dritës natyrore dhe artificiale për punë dhe lexim, ngrohje dhe ajrosje.”⁷

10. MKPT-ja, gjatë vizitës, vërejti se qelitë ku qëndronin të paraburgosurit kishin ndriçim të mjaftueshmë natyral dhe artificial, si dhe nuk kishin lagështi. Sa i përket hapësirës për banim për të burgosurit, MKPT-ja, si edhe në raportin e mëhershëm me rekomandime, konstaton se hapësira për banim, në disa qeli, nuk është në pajtim me dispozitat e LESPs-së dhe me standardet e përcaktuara nga Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës (në tekstin e mëtejmë *KPT*).⁸ Autoritetet e QPP-së janë të vetëdijshme për këtë mangësi dhe konsiderojnë se kjo ndodhë si pasojë e objektit të vjetër, i cili u ndërtua në vitin 1964 dhe në të cilin nuk mund të bëhen modifikime. Në të gjitha qelitë e vizituara, aty ku akomodohen të paraburgosurit, nuk kishte më shumë se katër të burgosur në një qeli.⁹
11. MKPT-ja ka vërejtur se dyshekët janë të vjetësuar dhe nuk janë ndërruar për kohë të gjatë dhe, për pasojë, në disa shtretër ka depërtuar lagështia. Përveç në QPP, MKPT-ja e ka vërejtur këtë problem edhe në disa qendra tjera korrektuese. Drejtori i QPP-së është i vetëdijshëm për këtë mangësi dhe ka dërguar kërkësë në Drejtorinë e Përgjithshme të ShKK-së, duke kërkuar që të evitohet kjo mangësi. MKPT-ja konsideron se kjo mangësi duhet të evitohet në QPP dhe në të gjitha qendrat tjera korrektuese.
12. **Sa i përket rekomandimit të MKPT-së që të gëlqerosen qelitë sipas vlerësimit dhe nevojës,** MKPT-ja vërejti se qelitë janë gëlqerosur. Sipas drejtorit, këto qeli janë gëlqerosur nga të burgosurit, ndërsa materialet janë siguruar nga buxheti i ShKK-së.
13. **Sa i përket rekomandimit të MKPT-së që të ndërmerren veprime për ta respektuar privatësinë e të burgosurve,** pasi që gjatë vizitës së fundit është vërejtur se disa tualetë nëpër qeli nuk kanë dyer, MKPT-ja pa se kjo mangësi është evituar nga autoritetet e QPP-së.
14. MKPT-ja ka pranuar ankesa nga të burgosurit për mungesë të mjeteve higjenike. MKPT-ja konsideron se autoritetet duhet t'u sigurojnë të paraburgosurve produkte higjenike që ua mundësojnë pastrimin e qelive dhe që ta mbajnë higjenën në mënyrë adekuate, në pajtim me nenin 38, paragrafi 2, të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.
15. Të paraburgosurit mund të bëjnë dush dy herë brenda javës, ndërsa të dënuarit nuk kanë kufizime. MKPT-ja vërejti se Rregullat Evropiane të Burgjeve përcaktojnë se të burgosurve duhet t'u mundësohet që të bëjnë dush së paku dy herë në javë.¹⁰ **MKPT-ja vërejti se dushet në pjesën ku akomodohen të paraburgosurit nuk ishin në gjendje të mirë higjenike dhe teknike.**

Mbipopullimi

16. Gjatë vizitës së realizuar më 20 maj 2019, në pjesën ku akomodohen të dënuarit, MKPT-ja vërejti se në disa qeli ishin të vendosur nga pesë persona. Po ashtu, MKPT-ja vërejti se

⁷ Ligji nr. 05/L-0-129, nen 3 i Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

⁸ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Hapësira e Banimit për një të Burgosur, shih: <https://rm.coe.int/16806cc449/>

⁹ Madhësia e qelive në fjalë sillet nga 11.5 m² deri në 13 m². Në të gjitha këto qeli janë të vendosur nga katër të burgosur.

¹⁰ Rregullat Evropiane të Burgjeve, Rregulli 19.4. Për më shumë: <https://rm.coe.int/european-prison-rules-978-92-871-5982-3/16806ab9ae.>

në disa qeli, për shkak të mungesës së hapësirës, disa të dënuar flinin në dysheme në dyshekë të vjetruar dhe pa mbulesa adekuate.

17. MKPT-ja, gjatë vizitës, lidhur me këtë gjendje bisedoi me drejtorin e QPP-së, i cili pohoi se do të punojnë për ta evitar këtë mangësi. Gjatë vizitës *ad-hoc*, e realizuar më 28 maj 2019, MKPT-ja vërejti se kjo situatë kishte ndryshuar dhe se vetëm një i burgosur flinte në dyshek në dyshemenë e qelisë. MKPT-ja konsideron se autoritetet kompetente duhet t'i ndërmarrin veprimet e nevojshme për ta evitar në tërësi këtë mangësi.

Ushqimi

18. LESP-ja përcakton të drejtën e të burgosurve për ushqim të përshtatshëm, për ruajtjen e mirë të shëndetit dhe të fuqisë së tij/saj, tri shujta për çdo ditë, të cilat duhet të jenë të llojullojshme dhe ushqyese. Ushqimi që i jepet personit të dënuar duhet t'i përshtatet moshës dhe gjendjes së tij shëndetësore, natyrës së punës, stinës e kushteve klimatike dhe, aq sa është e mundur, kërkeseve të tij fetare dhe kulturore.¹¹
19. Më tej ligji përcakton se personi i dënuar, i cili kryen punë të rënda, personi i sëmurë, gruaja shtatzënë, ose ajo e cila ka lindur fëmijë, kanë të drejtë për ushqim të caktuar nga mjeku edhe për ushqim dietal.¹² Mjeku, ose eksperti tjeter për ushqim, e kontrollon ushqimin dhe, para shërbimit të çdo shujte, e njofton drejtorin e institucionit korrektyues për cilësinë e ushqimit dhe konstatimet e tij i shënohen në librin përkatës.¹³
20. Gjatë vizitës, MKPT-ja vërejti se kushtet higjenike në kuzhinë ishin në nivelin e duhur dhe kuzhina ishte e pajisur me pajisjet e nevojshme për ta kryer punën në përgatitjen e ushqimit. Stafi i kuzhinës ishte i pajisur me libreza sanitare. Përveç stafit, të pajisur me libreza sanitare ishin edhe të dënuarit e angazhuar në punë. MKPT-ja nuk ka marrë ankesa nga të burgosurit sa i përket sasisë dhe kualitetit të ushqimit që u shërbeshet.

Regjimi

21. Në QPP, 12 të dënuar dhe 3 të paraburgosur janë të angazhuar në punë. Momentalisht të dënuarit angazhohen në punë për pastrim, në kuzhinë dhe për mirëmbajtje të caktuara të objektit. Të dënuarit kanë mundësi të dalin në shëtitje gjatë gjithë kohës, dyert i kanë të hapura prej orës 7:00 të mëngjesit deri në orën 7:00 në mbrëmje. Infrastruktura e burgut nuk lejon që të zhvillohen aktivitete të ndryshme, të cilat parashihen me LESP. Përpos shëtitjes, ata kanë në dispozicion një tavolinë ping-pongu, lojën e shahut dhe letra domino. TV-të ishin funksionalë dhe tanë QPP-ja kishte instaluar sistemin kabllor të TV-së dhe të burgosurit i kanë në dispozicion rreth 20 programe në TV.
22. Në rastin e të paraburgosurve, angazhimi i tyre në punë varet nga leja e gjykatës. MKPT-ja vërejti se, sa i përket angazhimit në punë të të paraburgosurit, neni 199, paragrafi 2, i Kodit të Procedurës Penale përcakton si në vijim: “*I paraburgosuri mund të kryejë punë të nevojshme për mbajtjen e rendit dhe pastërtisë në ambientin e tyre. Të paraburgosurit mund t'i lejohet të punojë në aktivitete që i përgjigjen aftësive fizike dhe mendore brenda mundësive dhe kushteve me të cilat disponon institucioni dhe me kusht që të mos e*

¹¹ Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 39, par. 1.

¹² Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 39, par. 2.

¹³ Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 39, par. 3.

dëmtojë procedurën penale. Gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues vendos për këtë në marrëveshje me drejtorinë e institucionit.”

23. Ndërsa neni 200, paragrafi 1, i LESP-së, lidhur me angazhimin e të paraburgosurit në punë, përcakton si në vijim: “*I paraburgosuri mund të angazhohet me punë në punëtori, punëtoritë e njësive ekonomike të cilat gjenden në rrethin e institucionit korrektaus përkatës pas marrjes së pëlgimit të gjykatës kompetente.*”
24. Po ashtu, Rregullat e Mandelës përcaktojnë të drejtën e të paraburgosurit për të punuar. Në Rregullin 116 të Rregullave të Mandelës shprehimisht theksohet: “*Të paraburgosurit duhet ti ofrohet mundësia të punojë, por nuk duhet ti kërkohet të punojë. Nëse ai/ajo përcaktohet që të punojë, ai/ajo duhet të paguhet*”.
25. Në raportin për vizitën në Republikën e Kosovës, realizuar në vitin 2015, i cili u publikua në vitin 2016, KPT-ja, lidhur me regjimin për të paraburgosurit, shprehu shqetësimin se, pavarësisht përpjekjeve të autoriteteve, të paraburgosurit shumicën e kohës e kalojnë në qelitë e tyre, përveç dy orëve të shëtitjes në ditë, duke shikuar TV dhe duke luajtur me letra.
26. Përmes këtij raporti, KPT-ja u kishte rekomanduar autoritetet kompetente në Republikën e Kosovës si në vijim: “*KPT, ri-përsërit rekomandimin që autoritetet të angazhohen që të rrisin aktivitetet jashtë qelisë për të paraburgosurit në të gjitha institucionet të cilat KPT i vizitoi, dhe në të gjitha institucionet tjera të Shërbimit Korrektaus të Kosovës ku një gjë e tillë është e përshtatshme.*” Më tej KPT-ja theksonte: “*Sa më e gjatë që është periudha e paraburgimit, aq më shumë duhet të zhvillohet regjimi i cili u ofrohet atyre. Po ashtu, duhet të ndërmerren veprime që edhe numri i personelit, ku një gjë e tillë është e nevojshme, të rritet.*”¹⁴
27. MKPT-ja konsideron se, bazuar në legjislacionin në fuqi, në Rregullat e Mandelës dhe në rekomandimet e KPT-së, autoritetet kompetente duhet të bëjnë përpjekje që të rriten angazhimet jashtë qelisë për të paraburgosurit jo vetëm në QPP, por edhe në qendrat tjera të paraburgimit, për aq sa një gjë e tillë është e mundur.

Kujdesi shëndetësor

28. Neni 43 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton se i dënuari ka të drejtë për shërbime shëndetësore pa pagesë. Personi i dënuar, të cilit nuk mund t'i ofrohet trajtim i duhur mjekësor në institucionin korrektaus, dërgohet në spitalin e burgut, në institucionin psikiatrik adekuat, ose në ndonjë institucion tjeter, për përkujdesje shëndetësore.¹⁵
29. Personeli mjekësor në QPP përbëhet nga një mjeke e rregullt, e cila punon me orar 8:00-16:00 dhe është në shërbim 24-orësh për thirrje telefonike; një psikologe, e cila është në shërbim me orar të plotë pune; ndërsa psikiatri punon çdo ditë nga 4 orë dhe në thirrje. Njësia shëndetësore në QPP nuk ofron shërbime të stomatologjisë, por të burgosurit dërgohen çdo të premte në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan; radiologu vjen në QPP për të bërë EHO. Sa i përket personelit të mesëm, njësia shëndetësore ka në dispozicion një

¹⁴ Raporti i KPT-së për vizitën në Kosovë, i publikuar në shtator 2016, paragrafi 46. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806a1efc>.

¹⁵ Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 43, par. 2.

- kryeinfermieri me orar të punës 8:00-16:00 dhe 5 infermieri të cilat punojnë në ndërrim 12 orësh. Shërbime tjera shëndetësore ofrohen në institucionet tjera publike shëndetësore.
30. Gjatë vizitës, MKPT-ja vërejti një praktikë shqetësuese, e cila ka të bëjë me marrjen e mostrave të gjakut, të cilat vendosen në epruvetë dhe pastaj dërgohen në laboratorin e Qendrës së Mjekësisë Familjare nga infermieri apo nga zyrtari korrektues. Lidhur me këtë praktikë, MKPT-ja, gjatë vizitës, menjëherë i rekomandoi QPP-së ndërprerjen e praktikës së tillë, e cila nuk është në pajtim me rregullat mjekësore dhe shkel konfidencialitetin e shërbimeve mjekësore.
31. **Sa i përket infrastrukturës ku ofrohen shërbimet mjekësore, pavarësisht rekomandimit të MKPT përmes raportit të mëhershëm, gjendja mbetet e njëjtë.** Në shfrytëzim është një dhomë e cila përdoret për të gjitha nevojat e kujdesit parësor nga mjeku i burgut, nga infermierët, nga psikologu kur ka raste për t'i trajtuar, si dhe është hapësirë e përhershme e qëndrimit të personelit shëndetësor.
32. Po ashtu, mungesa e hapësirës së veçantë për psikologun, i cili ofron shërbime psikologjike për rastet me probleme të ndryshme, si: rastet me tentim të vetëvrasjes, të vetëlëndimeve, me probleme emocionale, me përdorues të duhanit, të alkoolit, të drogave, e vështirëson punën e psikologut dhe nuk ofron konfidencialitet të shërbimeve mjekësore për të burgosurit që kanë nevojë për shërbime psikologjike. Afër njësisë shëndetësore ende është një hapësirë e cila shërben si depo për barëra aktualisht të përdorshme, si dhe të pakove me barëra me afat të skaduar. MKPT-ja nuk mori ankesa lidhur me respektimin e së drejtës për shërbime mjekësore.

Rëndësia e kontrolleve mjekësore për të burgosurit e sapo pranuar

33. KPT-ja vazhdimisht thekson rëndësinë e ekzaminimit mjekësor të të burgosurve të sapo pranuar, veçanërisht në institucionet të cilat përbëjnë pikë hyrjeje në sistemin e burgjeve. Një ekzaminim i tillë është esencial, veçanërisht për t'i parandaluar vetëvrasjet dhe përhapjen e sëmundjeve transmetuese (siç janë tuberkulozi, hepatiti B/C, HIV).
34. Sipas KPT-së, shërbimet mjekësore të burgut po ashtu mund të jepin kontribut të rëndësishëm në parandalimin e keqtrajtimit fizik gjatë periudhës menjëherë para burgosjes, domethënë, në periudhën kur personat janë në mbajtje nga agjencitë e zbatimit të ligjit, përmes regjistrimit sistematik dhe me kohë të lëndimeve dhe, kur kjo është e përshtatshme, përmes sigurimit të informatave për autoritetet relevante.¹⁶
35. Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale¹⁷ dhe Praktika Standarde e Veprimeve¹⁸ e DShB-së përcaktojnë obligimin që i burgosuri i sapo pranuar t'i nënshtrohet kontrollit mjekësor brenda 24 orëve nga momenti i pranimit.
36. Obligime të tilla përcaktohen edhe me aktet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve, siç janë: Rregullat e Mandelës¹⁹, Rregullat Evropiane të Burgjeve²⁰ dhe Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrotjen e të Miturve të Privuar nga Liria.²¹

¹⁶ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti i 26-të i Përgjithshëm, paragrafi 72, në: <https://rm.coe.int/168070d0c8/>

¹⁷ Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nen 31.

¹⁸ Praktika Standarde e Veprimeve, pika 1. Shih në: <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2013/11/1.-Praktikat-Standarde-te-Veprimit-n%C3%AB-DShB.pdf>

37. Bazuar në pohimet e të burgosurve dhe dokumentacionin relevant, të paso pranuarit, brenda 24 orëve, i nënshtronen kontolleve mjekësore në pajtim me LESP-në dhe me Praktikën Standarde të Veprimi të DShB-së.

Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore

38. Sa i përket konfencialitetit të shërbimeve mjekësore, MKPT-ja, bazuar në intervistat e zhvilluara me të burgosurit dhe me personelin shëndetësor, konstaton se këto shërbime jepen nën kushte të cilat respektojnë konfidencialitetin, respektivisht jepen pa praninë e zyrtarëve korrektues, përveç në raste kur prania e tyre kërcohët nga mjeku. Ndërsa në dosjen mjekësore të të burgosurit ka qasje vetëm personeli shëndetësor.
39. Megjithatë, siç u theksua edhe në paragrafin 30 të këtij raporti, praktika kur mostrat e gjakut dërgohen për ekzaminim në laborator nga zyrtarët korrektues dhe kur psikologu duhet të japë shërbime psikologjike pa pasur një hapësirë adekuate, nuk janë në pajtim me respektimin e konfidencialitetit të shërbimeve mjekësore.
40. Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore parashihet me Praktikën Standarde të Veprimit,²² e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë; parashihet me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale²³; me standartet e KPT-së;²⁴ si dhe me aktet ndërkombëtare, siç janë: Rregullat e Mandelës²⁵ dhe Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria.²⁶

Masat disiplinore

41. Sipas legjislacionit në fuqi, dënimet disiplinore që mund t'u shqiptohen të dënuarve janë: Qortimi, heqja e beneficionit të caktuar, urdhri për kompensim dhe vëtmia.²⁷ Kurse në rastin e të paraburgosurve, mund të shqiptohen dënimet si në vijim: Kufizimi apo ndalimi i vizitave apo i korresponcencës, përveç kontakteve me avokatin mbrojtës, me Avokatin e Popullit dhe me misionet diplomatike. Gjatë vizitës, MKPT-ja u njoftu nga drejtori se në QPP nuk aplikohet masa disiplinore e vëtmisë. MKPT-ja nuk mori ankesa nga të burgosurit lidhur me shqiptimin e masave disiplinore nga Drejtoria e QPP-së.

¹⁹ Rregullat e Mandelës, Rregulli 34. Shih në: https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/GA-RESOLUTION/E_ebook.pdf

²⁰ Këshilli i Evropës, Rekomandimi (2006) 2 i Këshillit të Ministrave për Shtetet Anëtare mbi Rregullat Evropiane të Burgjeve, pika 42.1. Shih në: <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016804c221d/>

²¹ Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria, pika 27, në: https://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/res45_113.pdf

²² Praktika Standarde e Veprimit, pika 11. Shih në: <https://msh.rks.gov.net/wp-content/uploads/2013/11/1.-Praktikat-Standarde-te-Veprimit-n%C3%AB-DShB.pdf>

²³ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 49.

²⁴ Standartet e KPT-së, publikuar në vitin 2018, paragrafët 50 dhe 51. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806ce943/>

²⁵ Rregullat e Mandelës, Rregulli 26, pika 2, në: https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/GA-RESOLUTION/E_ebook.pdf

²⁶ Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria, pika A, Rregulli 19, në: https://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/res45_113.pdf

²⁷ Paragrafët nga 101 deri në 113 të Ligjt nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

Kontakti me botën e jashtme

42. MKPT-ja konsideron se kontaktet me botën e jashtme, veçanërisht vizitat nga familja apo nga të afërmit e tjerë, janë të rëndësishëm thelbësore në kontekstin e rehabilitimit social të të burgosurve.
43. Legjislacioni në fuqi,²⁸ për rastin e personave të dënuar, përcakton se të burgosurit e dënuar kanë të drejtë të pakufizuar për korrespondencë (që u nënshtrohen përjashtimeve të caktuara), kanë të drejtë për një vizitë në muaj, e cila zgjat më së paku një orë, si dhe kanë të drejtë për një vizitë nga fëmijët dhe bashkëshortet e tyre, së paku një herë në 3 muaj, me kohëzgjatje minimale prej tri orësh. Sipas drejtorit të QPP-së, të burgosurit kanë të drejtë për një vizitë në javë. Vizitat në rastin e të paraburgosurve autorizohen nga gjykata kompetente.
44. Sa u përket thirrjeve telefonike, neni 60 i LESP-së përcakton se i dënuari ka të drejtë të bëjë thirrje telefonike. Në rastet e të paraburgosurve, këto telefonata autorizohen nga gjykata kompetente. Bazuar në informatat e siguruara nga drejtori i QPP-së dhe nga pohimet e të paraburgosurve, atyre u lejohen dy telefonata në javë, të cilat janë subjekt i lejes së gjykatës kompetente. Ndërsa në rastet e të dënuarve nuk ka kufizime.
45. MKPT-ja vizitoi edhe sallën e vizitave familjare, e cila ofron kushte të kënaqshme për të pranuar vizita familjare, si dhe ofron mundësinë që i burgosuri të ketë kontakt të drejtpërdrejtë (nuk ka bariera ndërmjet tyre) me familjarin apo personin nga i cili vizitohet.

Procedura e parashtrimit të ankesave

46. Standartet e KPT-së theksojnë rëndësinë e sistemit efektiv të parashtrimit të ankesave dhe e konsiderojnë atë si garanci themelore kundër keqtrajtimit në burgje dhe në qendra të paraburgimit.²⁹
47. Neni 91 i LESP-së përcakton në hollësi procedurën, sipas së cilës të paraburgosurit dhe të dënuarit mund t'i drejtohen me ankesë apo me lutje drejtorit të një institucioni të caktuar të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Procedura përfshin edhe afatet për përgjigje nga drejtori dhe mundësinë që ankesa t'i drejtohet një autoriteti tjeter, që në rastin e tanishëm është Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Korrektues dhe ministri i Drejtësisë.³⁰
48. MKPT-ja vërejti se në dispozicion të të burgosurve në QPP gjenden kutitë e ankesave, të vendosura nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, kutitë e ankesave të vendosura nga Institucioni i Avokatit të Popullit dhe ato të DShB-së. Kutitë e ankesave të vendosura nga Institucioni i Avokatit të Popullit mund të hapen vetëm nga personeli i këtij institucionit, gjë që për ankuesit ofron konfidencialitet në parashtrimin e ankesës.
49. Po ashtu, ata mund t'i drejtojnë ankesë Avokatit të Popullit edhe përmes linjës telefonike pa pagesë (informatat për linjën telefonike janë të vendosura në kutitë e ankesave),

²⁸ Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nenet 62-65.

²⁹ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti i 27-të i Përgjithshëm, paragrafi 68. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16807bc668>.

³⁰ Neni 91, paragrafi 4, i Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton: "Në ankimin e paraqitur, drejtori i institucionit korrektues do të përgjigjet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, ndërsa Zyra Qendrore e Shërbimit Korrektues në afat prej tridhjetë (30) ditësh. Në ankimin me shkrim do të jepet përgjigja në formën e shkruar."

përmes postës së irregullt, e cila, sipas LESP-së, nuk i nënshtrohet kontrollit nëse i adresohet Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës, si dhe përmes familjarëve të tyre.

50. MKPT-ja vërejti se të burgosurve në QPP u ofrohet mundësia adekuate për parashtrim të ankesave dhe të kërkesave. Ky institucion i shqyrton ato dhe u dërgon përgjigje të burgosurve në këtë qendër, në pajtim me LESP-në. Po ashtu, QPP-ja i regjistron të gjitha ankesat dhe kërkesat e të burgosurve në dosjet e tyre administrative. MKPT-ja nuk mori ankesa nga të burgosurit, sa i përket së drejtës për të parashtruar ankesë.

Vizitat në QPP nga kryetari i Gjykatës Themelore të Prizrenit

51. Nga pikëpamja e MKPT-së, gjyqtarët kanë rol thelbësor në parandalimin e torturës dhe keqtrajtimit fizik, duke u interesuar për trajtimin e personave të arrestuar (të cilët sillen para gjyqtarit të procedurës paraprake), duke vizituar qendrat e paraburgimit dhe duke u interesuar për trajtimin e tyre, si dhe duke u siguruar për respektimin e të drejtave të tyre themelore.
52. Neni 203 i Kodit të Procedurës Penale thekson rolin dhe përgjegjësitë e kryetarit të gjykatës themelore kompetente sa i përket trajtimit të të paraburgosurve.
53. Në këtë drejtim, neni 203, paragrafi 1, i Kodit të Procedurës Penale shprehimisht përcakton: “*Kryetari i gjykatës themelore kompetente ka përgjegjësinë përfundimtare për mbikëqyrjen e trajtimit të të paraburgosurve.*” Ndërsa nenı 203, paragrafi 2, shprehimisht thekson: “*Kryetari i gjykatës themelore kompetente ose gjyqtari i cili ka urdhëruar paraburgimin, në çdo kohë mund të vizitojë të paraburgosurit, të bisedojë me ta dhe të pranojë ankesat e tyre.*”
54. Kurse nenı 62, paragrafi 5, i LESP-së shprehimisht përcakton: “*Kryetari i gjykatës themelore kompetente ku gjendet institucioni korrektues, ose i deleguari i tij mund t'i vizitojë dhe të flasë me personat e dënuar në çdo kohë, ose me kërkesën e tij.*”
55. Gjatë vizitës në QPP, MKPT-ja u njoftua nga drejtori dhe të burgosurit se kryetari i Gjykatës Themelore në Prizren disa herë i ka vizituar të burgosurit dhe është interesuar për trajtimin e tyre në QPP. MKPT-ja mirëpret këtë zhvillim dhe inkurajon të gjithë kryetarët e gjykatave kompetente që, në pajtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale dhe të LESP-së, t'i vizitojnë të burgosurit dhe të interesohen për trajtimin e tyre.

Personeli i QPP-së dhe çështje të ndërlidhura me sigurinë


56. Sipas drejtorit, QPP-ja përballet me mungesë të vogël të zyrtarëve korrekta, pasi që disa zyrtarë korrekta janë duke u shkolluar në Akademinë për Siguri Publike. Sa i përket rekomandimit të MKPT-së për përmirësim të kushteve të punës së zyrtarëve korrekta, gjendja mbetet e njëjtë. Sikurse në qendrat tjera korrekta, MKPT-ja vërejti se zyrtarët korrekta janë të pajisur me të ashtuquajturin *peper spray*, të cilat i ka skaduar afati i përdorimit. Në përgjithësi, hapësirat e QPP-së janë të pajisura me kamera të sigurisë dhe shumica e tyre janë funksionale, të cilat, për nga pikëpamja e MKPT-së dhe e KPT-së, ato janë garanci shtesë kundër keqtrajtimit fizik dhe kundër akuzave eventuale të rrejshme ndaj zyrtarëve korrekta.

Në bazë të të gjeturave dhe të konstatimeve të arritura gjatë vizitës, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; me nenin 16, paragrafi 4, të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i rekomandon:

Ministrisë së Drejtësisë:

- Të burgosurit të furnizohet me mjete higjenike, në pajtim me LESP-në.
- Të evitojen mangësitë teknike të funksionimit të dusheve, sipas nevojës.
- Të shtohen aktivitetet jashtë qelisë për të paraburgosurit, në pajtim me Kodin e Procedurës Penale dhe me LESP-në dhe për aq sa një gjë e tillë është e mundur në QPP.
- QPP-ja të furnizohet me dyshekë të rinj dhe cilësorë.
- Të ndërpritet praktika e dërgimit të mostrave të gjakut në laborator jashtë QPP-së nga zyrtarët korrektues.
- MKPT ripërsërit rekomandimin që të krijojen kushte adekuate pune për personelin mjekësor dhe korrektues.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“*Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkua e në pajtim me ligj*”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“*Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë*”), ju lutemi mirësish që të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.


Me nderime,
Hilmi Jashari
Avokat i Popullit